



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:166270

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06884616

C. nr.680/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Fejzullah (Muharrem) Thaqi nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, të cilin me autorizim e përfaqëson Enver Halili avokat në Gjilan, kundër të paditurve Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Enver Ajvazi avokat në Kamenicë, me objekt kontesti për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 5,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të përkohshëm, më datën 18.02.2025 perpiloi kete:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Fejzullah (Muharrem) Thaqi nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, të cilin me autorizim e përfaqëson Enver Halili avokat në Gjilan, kundër të paditurve Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq tani me adresë të panjohur, të cilet i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Enver Ajvazi avokat në Kamenicë, dhe;

II. VËRTETOHET se paditësi Fejzullah (Muharrem) Thaqi nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës, është pronar, në bazë të mbajtjes me mirëbesim (parashkrimit fitues), i ngastrave kadastrale me numër : P – 759-0, ZK Shipashnicë e Poshtme, Komuna e Kamenicës, me sipërfaqe prej 486 m2 me kulturë arë e klasës 4, në vendin e quajtur “ner vade Lumi i

Shipashnicës” dhe P – 760-0, ZK Shipashnicë e Poshtme , Komuna e Kamenicës, me sipërfaqe prej 2356 m2 me kulturë arë e klasës 3, në vendin e quajtur “ner vade Lumi i Shipashnicës”, te cilat në DKGJP evidentohen ne bashkëpronësi ne emër te pronarëve, Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 21/40, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 1/8, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40.

III. DETYROHEN te paditurit, Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq 21/40, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq 1/8, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq 7/40 dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq 7/40, tani me vendbanim të panjohur, që paditësit t’ia njohin të drejtën e pronësisë mbi ngastrat kadastrale të cekur si në pikën II të këtij dispozitivi, në afat prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

IV. Përfaqësuesit të përkohshëm, avokatit Enver Ajvazi nga Kamenica, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, respektivisht në emër të punës së tij, i njihet dhe njëkohësisht i paguhet (deponohet) shuma prej 1,274.00 euro.

A r s y e t i m

1. Rrjedha e procedurës

Paditësi Fejzullah Thaqi, më datën 25.11.2020, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurve, Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq tani me adresë të panjohur, për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me vlerë të objektit të kontestit prej 5.000 euro.

Meqenëse të paditurit, Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq tani me adresë të panjohur, nuk ka qenë e mundur t’ju gjendet adresa e saktë e vendbanimit apo vendqëndrimit edhe pas tentimit të bërë nga gjykata që të njëjtëve t’ju gjendet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, përmes institucioneve relevante, gjykata me propozimin e palës paditëse e në kuptim të dispozitës së nenit 79 paragrafi 3, pika a), dhe nenit 81 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), ia ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm të paditurit dhe atë Enver Ajvazi, avokat në Kamenicë.

2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësit, avokati Enver Halili, në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit ka deklaruar se, mbetet pranë padisë dhe parashtrësive të dorëzuara në këtë çështje kontestimore dhe se tani paditësi është pronar faktik i ngastrave kadastrale P – 759-0, me sipërfaqe prej 486 m², në vendin e quajtur “Ner vade Lumi i Shipashnices” ne ZK Shipashnicë e Poshtme dhe P – 760-0, me sipërfaqe prej 2356 m², në vendin e quajtur “Ner vade Lumi i Shipashnicës” ZK Shipashnicë e Poshtme, të cilat paditësi i ka blerë në vitin 1978 është paguar çmimi në tërësi ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Meqë ka kaluar një periudhë e gjatë që paditësi e ka shfrytëzuar menjëherë pas pagesës dhe nga dëshmitari është vërtetuar se paditësi asnjëherë nuk ka qenë i penguar nga askush, vërtetohet se paditësi i ka shfrytëzuar në mënyrë të qetë dhe pa pengesa këto paluajtshmëri. Po ashtu me daljen në vendngjarje me ekspertin e gjeodezisë u konstatua dhe u vërtetua gjendja faktike e këtyre ngastrave kontestuese, dhe sipas tij këto rrethana janë të mjaftueshme për të vërtetuar se kërkesë padia e paditësit është me bazë ligjore dhe e mbështetur në fakte dhe prova që janë administruar edhe gjatë procesit kontestimor, andaj i ka kërkuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit, dhe të vërtetohet se i njëjti është pronar i ngastrave kadastrale si në precizimin e kërkesëpadisë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm, avokati Enver Ajvazi, në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet pranë përgjigjes në padi, ndërsa ka theksuar se në shqyrtimin kryesor është vërtetuar se paditësi i kishte blerë ngastrat që janë objekt kontesti dhe po ashtu në bazë të dëshmisë u vërtetua se nuk është penguar nga askush asnjëherë në posedim. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në vlerë totale prej 1,274.00 euro.

3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova materiale dhe personale: Certifikatat me numër të lëndës 129/2024 e datës 05.12.2024 në emër të Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 21/40, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 1/8, Ratomir (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 si bashkë posedues, ekspertiza gjeodezike e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 09.12.2024 e hartuar nga eksperti i gjeodezisë Diamant Latifaj, dhe dëgjimi i dëshmitarit Sokol Keka.

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të të autorizuarit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të përkohshëm dhe provave materiale dhe personale të lartcekura, në kuptim të

dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar në ligj.

Gjykata ka konstatuar se në mes palës paditëse dhe përfaqësuesit të përkohshëm, nuk ishte kontestues fakti se paditësi i ka blerë, i ka në posedim faktik, i shfrytëzon dhe i punon i pa penguar nga askush ngastrat kadastrale kontestuese të lartcekur.

3.1. Provat Materiale

Me leximin e Certifikatave të pronës me numër të lëndës 129/2024 e datës 05.12.2025, gjykata e vërtetoi faktin se ngastrat të cilat janë objekt i kësaj çështje kontestimore, në kohën e nxjerrjes së certifikatave janë evidentuar në emrin e Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 21/40, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 1/8, Ratimir (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 si bashkë posedues.

Po ashtu nga ekspertiza gjeodezike e lartcekur u konstatua se, parcelat kadastrale me numër 759-0, ZK Shipashnicë e Poshtme, K. Kamenicë është në bashkëpronësi të Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 21/40, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 1/8, Ratimir (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40, me sipërfaqe të përgjithshme prej S-486 m², me kulturë Arë e Klasës 4, vendi i quajtur “Ner Vade Lumi i Shipashnicës”. Në gjendjen faktike të kësaj parcele janë të lavëruara dhe të punuara nga paditësi, ndërsa kufizohet në anën veriore me gjatësi prej 8.40m me parcelën 758 – 0 ZK Shipashnicë e Poshtme e cila evidentohet si pronë private në emër të Selami Dërmaku, Shaban Dërmaku dhe Mehmet Dërmaku, në anën Perëndimore me gjatësi prej 35.44m (pika 4 deri te pika 8) me parcelën 760-0 ZK Shipashnicë e Poshtme e cila evidentohet si pronë private në emër të Miroslav S. Stevanovic 7/40, në anën Lindore me gjatësi prej 6.87m dhe 23.63m me parcelën 776-1,2,3 (mungesë e shënimeve para vitit 1999) e cila evidentohet si pronë private në emër të 776-1 Zijadin dhe Nuri Leka, 776-2 Qamilje Leka, 776-3 Shukri Leka, në anën Jugore me gjatësi prej 25.62 me parcelën 761-0 ZK Shipashnicë e Poshtme e cila evidentohet si pronë private në emër të Muharrem Thaqit.

Ndërsa parcela kadastrale me numër 760-0, ZK Shipashnicë e Poshtme, K. Kamenicë, është në bashkëpronësi të të Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 21/40, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 1/8, Ratimir (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40 dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq pjesa e pronës 7/40, me sipërfaqe të përgjithshme prej S-2356 m², me

kulturë Arë e Klasës 3, vendi i quajtur “Ner Vade Lumi i Shipashnicës”. Në gjendjen faktike të kësaj parcele janë te lavëruara dhe te punuara nga paditësi, ndërsa kufizohet në anën veriore me gjatësi prej 16.40m, 32.05m 27.64m me parcelën 758 – 0 ZK Shipashnicë e Poshtme e cila evidentohet si pronë private në emër të Selami Dërmakut, Shaban Dërmakut dhe Mehmet Dërmakut, në anën Perëndimore me gjatësi prej 15.63m, 17.55m me parcelën 757-0 ZK Shipashnicë e Poshtme e cila evidentohet si Pronë Shoqërore Kuvendi Komunal Kamenicë, në anën Lindore me gjatësi prej 35.44m me parcelën 759-0 Shipashnicë e Poshtme evidentohet si pronë private në emër të bashkëpronarëve, Miroslav S. Stevanovic 21/40, Miodrag S.Stevanovic 1/8, Ratomir S.Stevanovic7/40, Milivoje S.Stevanovic 7/40 me sipërfaqe 486 m² arë e klasës 4 në vendin e quajtur “Nër Vadë Lumi i Shipashnicës”, në anën Jugore me gjatësi prej 70.26 me parcelën 762-0 ZK Shipashnicë e poshtme e cila evidentohet si pronë private në emër të Muharrem Thaqit.

3.2. Dëgjimi i dëshmitarit Sokol Keka

Dëshmitari Sokol Keka nga fshati Muçivërc, Komuna e Kamenicës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.01.2025, ka deklaruar se paditësi ngastrat kontestuese i ka blerë në vitet e 80-ta, dhe në këto ngastra i ka punuar, pas blerjes së paluajtshmërisë menjëherë ka hyrë në posedim dhe ka deklaruar se ka njohuri se paditësi i ka paguar çmimin në tërësi dhe asnjëherë nuk është penguar nga askush, për sa i përket bartjes pas momentit të shitblerjes ka deklaruar se paditësi nuk ka mundur të bëjë bartjen dhe sipas njohurive të tij kanë qenë të penguar nga shteti për bartjen e paluajtshmërive nga serbët tek shqiptarët.

4. Baza juridike

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata gjeti se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit gjenë mbështetje në dispozitën ligjore të nenit 28 paragrafi 4, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, (Gazeta Zyrtare RSFJ Nr.6/80), ku përcaktohet se “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”, dhe erdhi në përfundim se në rastin konkret janë përmbushur 3 (tri) kriteret themelor që paraqesin bazën për fitimin e së drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes e që janë: ndërgjeshmëria, posedimi dhe koha, me çka duke e pasur parasysh se për gjykatën u bë jokontestues fakti se paditësi, ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të qetë dhe të lirë në paluajtshmëritë – ngastrat kadastrale që janë objekt i këtij kontesti, duke i punuar dhe mbjellë të

njëjtat, si mbajtës me mirëbesim, që nga viti 1978, kur edhe i ka blerë, e deri më tani, pa u penguar dhe shqetësuar nga askush, e as nga vet të paditurit e lartcekur, gjykata duke u mbështetur në provat materiale, deklarin e dëshmitarit dhe ekspertizën e ekspertit gjeodet, e të cilave prova gjykata ua fali besimin e plotë, e vërtetoi faktin paditësi Fejzullah Thaqi, i ka në posedim të qetë, me mirëbesim, të lirë dhe të pa penguar nga askush këto paluajtshmëri kontestuese të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykim dhe tani paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë kontestuese, në bazë të mbajtjes për më tepër se 20 vite, respektivisht që rreth 40 vite. Për më tepër, zgjidhjen e njëjtë si në rastin konkret e parasheh edhe dispozita e nenit 40 paragrafi 1, të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, (Ligji Nr. 03/L-154), ku përcaktohet se *“Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të”*, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar në tërësi si të bazuar në ligj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke i pasur parasysh provat materiale, dëshminë e dëshmitarit, të cekura si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se paditësi Fejzullah Thaqi, e ka në posedim faktik dhe të qetë, pa u penguar nga askush madje nga as vet te paditurit, në shfrytëzimin dhe punimin e lirë të paluajtshmërisë – ngastrave kadastrale te cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e shfrytëzuar të njëjtën që mbi 40 vite, ngase gjykata e ka vërtetuar se tani paditësi, në vitin 1978, e kishte blerë ngastrën kadastrale të cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga tani te paditurit e lartcekur dhe se që nga ajo kohë, paditësi, ka hyrë në posedim faktik dhe të qetë në këtë ngastër kadastrale duke e shfrytëzuar dhe punuar pra, paditësi nuk ka asnjë shqetësim apo pengesë në shfrytëzimin e tyre, me çka gjykata e vërtetoi faktin se paditësi i ka në posedim faktik dhe me mirëbesim, të qetë dhe të pa penguar nga askush këto ngastra kadastrale kontestuese që mbi 40 vite, e rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e pronësisë nga paditësi mbi ngastrat kadastrale kontestuese në bazë të mbajtjes për më shumë se 20 vite, kritere këto të parapara me dispozitën e nenit 28 paragrafi 4, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike. Deri te ky përfundim, gjykata ka ardhur duke i marr për bazë dëshminë e dëshmitarit, ngase deklarata e tij ishte e sinqertë, objektive dhe në harmoni të plotë më provat e tjera materiale, e të të cilës deklaratë gjykata ua fali besimin e plotë dhe e mori për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ngase nga kjo deklaratë gjykata e ka vërtetuar faktin se paditësi, në vitin 1978, ngastrat kadastrale kontestuese i kishte

marrë në posedim faktik dhe shfrytëzim në bazë të shitblerjes, e që përmes dëshmisë së këtij dëshmitari gjykata e ka vërtetuar edhe faktin se paditësi Fejzullah Thaqi, këto ngastra kadastrale kontestuese i ka blerë nga tani te paditurit – shitësi Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq, Ratimir (Sllobodan) Stefanoviq dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq tani me adresë të panjohur, si dhe nga këto deklarata gjykata e ka vërtetuar edhe faktin se paditësi këto ngastra kadastrale i ka poseduar, shfrytëzuar dhe punuar që nga koha kur i kishte blerë, respektivisht nga viti 1978, pa u penguar nga askush asnjëherë, e as nga vet te paditurit, ngase sipas dëshmisë së dëshmitarit paditësi asnjëherë nuk ka pasur ndonjë mosmarrëveshje lidhur me këto ngastra kadastrale kontestuese të cilat i ka në posedim dhe shfrytëzim.

Përveç dëshmisë së dëshmitarit, gjykata e mori për bazë edhe ekspertizën e ekspertit gjeodet të elaboruar si më lartë, e të cilës gjykata ia fali besimin e plotë, ngase në këtë ekspertizë është përshkruar në detaje gjendja faktike e parcelave – ngastrave kadastrale kontestuese, përkufizimi i tyre me ngastrat e tjera dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre nga tani paditësi. Andaj, duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat, gjykata gjeti se padia dhe kërkesëpafia e paditësit është e bazuar në ligj dhe e njëjta si e tillë duhet të aprovohet në tërësi, me çka gjykata erdhi në përfundim dhe ia njohu të drejtën e pronësisë paditësit, mbi ngastrat kadastrale kontestuese të cekur si në piken II të dispozitivit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Shpenzimet e procedurës kontestimore

Gjykata ka konstatuar se pala paditëse nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore, ndërsa duke u bazuar në dispozitën e nenit 81 paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ka detyruar palën paditëse, që në emër të punës së përfaqësuesit të përkohshëm, ta deponoj shumën e të hollave prej 1,274.00 euro, në xhirollogarinë – arkën e kësaj gjykatën.

Ndërsa, gjykata ka vendosur që në emër të shpenzimeve të shkaktuara për punën e tij, si përfaqësues i përkohshëm, duke vepruar në emër të të paditurve, Miroslav (Sllobodan) Stefanoviq, Miodrag (Sllobodan) Stefanoviq, Ratimir (Sllobodan) Stefanoviq dhe Milivoje (Sllobodan) Stefanoviq tani me adresë të panjohur, avokatit Enver Ajvazi nga Kamenica, t'ia njeh shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,274.00 euro, e cila shumë e hollave, nga xhirollogaria – arka e kësaj gjykate, do t'i bartet në xhirollogarinë personale të avokatit Enver Ajvazi nga Kamenica.

Andaj, nga të cekurat si më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si dhe në dispozitën e nenit 28 paragrafi 4, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, e lidhur me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1, të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

G j y q t a r j a,
Valbonë Dërvodeli, d.v

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, pas datës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.